



**Memorandum i mirëkuptimit mbi trajnimet e detyrueshme dhe trajnimeve
shtesë për prokurorë
ndërmjet
Akademisë së Drejtësisë
dhe
Këshillit Prokurorial të Kosovës**

Ky memorandum mirëkuptimi (në tekstin e mëtutjeshëm *Memorandumi*) është lidhur më (22 nëntor 2021) nga Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm “*palët*”).

1. Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1) Qëllimi i këtij Memorandumi është që të përcaktojë kushtet, fushëveprimin e punës dhe përgjegjësitë e palëve lidhur me trajnimin e detyrueshëm dhe shtesë për prokurorët.
- 2) Fushëveprimi i këtij Memorandumi përfshin trajnimin për prokurorët të cilët vlerësohen me performancë “pamjaftueshëm” dhe për këtë arsye rekomandohen për trajnim të detyrueshëm dhe trajnim shtesë.

2. Historiku

Palët dakordohen se ky Memorandum është i nevojshëm për të adresuar performancën e pamjaftueshme të prokurorëve të dokumentuar me vlerësimin e performancës. Qëllimi i palëve është që të sigurojnë sistem prokurorial profesional.

3. Përgjegjësitë

- 1) Në kuadër të këtij Memorandumi, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ndërmerr veprimet sa vijon:
 - a) Sekretariati i KPK-së siguron që vendimet e arsyetuara me shkrim të KPK-së i dorëzohen me kohë AD-së.
 - b) Vendimi i Këshillit përmban rekomandime specifike mbi temat/fushat që do të trajtohen nga AD gjatë trajnimit të detyrueshëm dhe trajnimit shtesë.
 - c) KPK siguron caktimin e prokurorëve me performancë të dëshmuar të dalluar si mentorë për prokurorët që janë duke vijuar trajnimet e detyrueshme dhe shtesë.
 - d) KPK-ja e rishikon certifikatën dhe raportin e AD-së mbi mjaftueshmërinë dhe ia përcjellë atë Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të KPK-së.

- 2) Në kuadër të këtij Memorandumi Akademia e Drejtësisë (AD) ndërmerr veprimet sa vijon:
 - a) AD-ja administron trajnimet sipas udhëzimeve nga vendimi i KPK-së.
 - b) AD-ja sigurohet që të ketë burime në dispozicion për zbatimin e kërkesës së KPK-së për trajnim të detyrueshëm dhe shtesë.
 - c) AD-ja sigurohet që të bëhet vlerësimi përfundimtar i vijuesit të trajnimit dhe certifikata përkatëse t'i paraqitet Komisionit.
 - d) AD-ja siguron që trajnerët e caktuar për trajnimin e detyrueshëm dhe shtesë kanë performancë të dëshmuar të suksesshme. AD-ja i zëvendëson trajnerët sa herë që ka raste të dokumentuara mbi performancën e dobët ose etikën e dobët të punës.
 - e) ADK-ja i raporton KPK-së për çdo çështje që lidhet me trajnerët dhe mentorët e që kërkon veprim të Këshillit.

4. Afatet dhe kushtet

Është kuptuar dhe dakorduar reciprokisht nga dhe mes palëve që:


- a) Secila palë merr përgjegjësinë për të përmbushur detyrat dhe obligimet që burojnë nga ky Memorandum.
- b) Akademia e Drejtësisë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës do të dakordohen mbi aspektet procedurale të protokolleve të bashkangjitura.
- c) Ky Memorandum mund të ndryshohet me marrëveshje reciproke të palëve përmes ndryshimit dhe plotësimit me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
- d) Ky Memorandum shkëputet nëse në të ardhmen kjo çështje rregullohet nga legjislacioni përkatës në fuqi.

5. Protokollet e përbashkëta


Protokollet e përbashkëta të KPK-së dhe AD-së janë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi. Protokollet mund të rishikohen ashtu siç konsiderohet e nevojshme pa pasur nevojë të ndryshohet Memorandumi nëse ato ndryshime nuk kanë ndikim në vetë Memorandumin.

6. Data e hyrjes në fuqi dhe nënshkrimi

Ky Memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët. Palët e shprehin dakordimin me këtë Memorandum përmes vendosjes së nënshkrimeve të tyre më poshtë.



Këshilli Prokurorial i Kosovës
Jetish Maloku, Kryesues i KPK-së



Akademia e Drejtësisë
Enver Fejzullahu, Drejtor i AD

Data: 22 nëntor 2021